



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.287/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik GI SDP-Oliver Ivanoviç, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët e tyre për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 23.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si e bazuar ankesa me nr. ZLAnr.287/2017 e dt. 20.10.2017 e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, subjektit politik GI SDP-Oliver Ivanoviç, me seli në Mitrovicën e Veriut, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 550 (pesëqind e pesëdhjetë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët të cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarrimit**.

## A r s y e t i m

Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, ka parashtruar 1 ankesë ZLAnr. 287/2017 e dt.20.10.2017 në të cilën pretendon se me datë 20.10.2017, në rrugët “Sutjeska” dhe ” Ivo Lola Ribar”, aktivistet e GI SDP- Oliver Ivanovic, kanë dëmtuar materialin promovues të subjektit politik Srpska Lista dhe kanë mbuluar posterat e Srpska Listës, veprimi i cili është në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe Rregullën Zgjedhore nr. 11/2013, konkretisht me nenin 4.

Sipas parashtruesit të ankesës këto veprimet të ndaluara janë bërë nga aktivisti i GI SDP - Andrija Stevanovic dhe nga kandidati i GI SDP për këshilltar, Dusan Milunovic.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesit kanë bashkangjitur disa fotografi, nga secili vende ku pretendohet të kenë ndodhur shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjet në ankesë të ofruar nga subjekti politik GI SDP-Oliver Ivanoviç, ka theksuar se nuk mund ti mohojnë shkeljet, mirëpo veprimet në fotografi paraqesin një reagim të

planifikuar dhe spontan të aktivistëve të tyre sepse gjatë gjithë fushatës zgjedhore Srpska Lista kanë grisur, djegur dhe mbuluar posterat e subjektit politik GI SDP-Oliver Ivanoviç.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se aktivistet subjekti politik GI SDP-Oliver Ivanoviç kanë mbuluar posterat e subjektit politik Srpska Lista, në rrugët “Sutjeska” dhe ” Ivo Lola Ribar”, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të 20.10.2017,

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik GI SDP-Oliver Ivanoviç, me seli në Mitrovicën e Veriut, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, posterat janë dëtuar dhe mbuluar, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika a) e LZP-së, e cila përcakton: *“Heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e subjektit tjetër politik;*

Nga arsyet e theksuara më lartë, ankesa e parashtruar nga subjekt politik Srpska Lista u miratua si e bazuar pasi që pretendimet në ankesë janë të bazuara në fakte bindëse ku vërtetohet se subjekti politik GI SDP-Oliver Ivanoviç ka bërë shkeljen e Kodit të Mirësjelljes. Paneli, vendimin e tij e mbështeti në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së GI SDP-Oliver Ivanoviç, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij kanë pranuar shkeljet e supozuara, dhe kanë ndërmarrë masa përmirësuese të cilat ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Zl.Anr. 287/2017 më datën 23.10.2017

**Kryesuesi i Panelit  
Gyltene Sylejmani**



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.*